

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rasti Gotovina, shpresa për ish-krerët e UÇK-së: Si u përmbys në Apel dënimi i gjeneralit kroat - Informo hu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/rasti-gotovina-shpresa-per-ish-kreret-e-uck-se-si-u-permbys-ne-apel-denimi-i-gjeneralit-kroat/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 15:54:44 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 15:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	56d608871ba89470363ed82ba73d04a8a6cb8397ffef466a19358443e07a479c
TEKSTI	8b8e939a6e603b3e36d8dece4f1331d67edfcb8504933fc3be762de4d414d65b
PAMJA	063c80604a4267036ec48496b0c0e0761f13dc251737785a81bf99baf7cf8f7c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3abb196d23afafa0dba943391b0c1d3595861b5432e7f7563797ebfab256e0c3
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	6d78d2dc60f31cde5fa6ff278c9155b75ea76fff53014b2b93764708aa00c94f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3abb196d23afafa0dba943391b0c1d3595861b5432e7f7563797ebfab256e0c3>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » Rasti Gotovina, shpresa për ish-krerët e UÇK-së: Si u përmbys në Apel dënimi i gjeneralit kroat

KOSOVË

Demo

Rasti Gotovina, shpresa për ish-krerët e UÇK-së: Si u përmbys në Apel dënimi i gjeneralit kroat

SEPTEMBER 16, 2026



Dënimet e dhëna nga Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, në total 81 vite burgim, kanë rikthyer vëmendjen te faza e apelimit dhe mundësia që vendimet e shkallës së parë të ndryshojnë.

Një prej rasteve më të njohura të drejtësisë ndërkombëtare që përmendet në këtë kontekst është ai i gjeneralit kroat Ante Gotovina, ndaj të cilit një vendim i shkallës së parë u përmbys tërësisht nga Dhoma e Apelit.

Gotovina ishte një prej komandantëve kryesorë të Ushtrisë Kroate gjatë luftës për pavarësinë e vendit. Ai drejtoi forcat kroate gjatë operacionit ushtarak "Stuhia", në vitin 1995, i cili solli rikthimin e kontrollit të një pjese të konsiderueshme të territorit kroat nën kontrollin e Zagrebit dhe shënoi një nga momentet vendimtare të përfundimit të luftës.

Pas përfundimit të luftës, Gotovina u shpall i kërkuar nga Tribunali Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë. Pas disa vitesh në arrati, ai u arrestua në Spanjë në vitin 2005 dhe u transferua në Hagë.

Në prill të vitit 2011, Gjykata e Hagës e shpalli fajtor në shkallë të parë dhe e dënoi me 24 vite burgim për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Gjykata e konsideroi atë përgjegjës, ndër të tjera, për veprime të paligjshme gjatë operacionit "Stuhia".

Por vendimi nuk ishte përfundimtar.

Mbrojtja e Gotovinės e apeloj vendimin, ndërsa çështja u shqyrtua nga Dhoma e Apelit e Tribunalit të Hagës.

Më 16 nëntor 2012, Apeli rrëzoi vendimin e shkallës së parë. Me shumicë votash, gjyqtarët e Apelit përmbysën gjetjet kryesore që kishin çuar në dënimin e Gotovinės dhe e shpallën atë të pafajshëm.

Gjykata urdhëroi lirinë e menjëhershme të tij, duke e kthyer një dënim prej 24 vitesh burgim në një vendim pafajësie.

Rasti i Gotovinės mbetet një nga shembujt më të rëndësishëm se një vendim i shkallës së parë në drejtësinë ndërkombëtare nuk është domosdoshmërisht përfundimtar dhe se procesi i apelimit mund të sjellë ndryshime thelbësore në vlerësimin e provave dhe përgjegjësisë penale.

Për ish-krerët e UÇK-së, tashmë pritët të hapet një tjetër fazë e procesit gjyqësor. Mbrojtja e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit ka paralajmëruar apelinin e vendimeve, ndërsa Dhoma e Apelit do të shqyrtojë argumentet e palëve dhe gjetjet e shkallës së parë.

Megjithatë, rasti Gotovina nuk nënkupton se një rezultat i ngjashëm do të përsëritet në çështjen e ish-

Postimet e reja

Rasti Gotovina, shpresa për ish-krerët e UÇK-së: ...

SEPTEMBER 16, 2026

Serwer: Specialja kriminalizoi një lëvizje...

SEPTEMBER 16, 2026

Çahet tubacioni kryesor i Bogovës, ndërpritet...

SEPTEMBER 16, 2026

Alban Skënderaj reagon pas vendimit ndaj ish-...

SEPTEMBER 16, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 15, 2026

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznese të paktën 1-vjeçare

Pas shpalljes së listës së fituesve të "Grant 2026" kanë nisur të dalin rastet ku...

Skema sesi IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%!

Skandal me sallamin në dyqanet Conad, thirrje konsumatorëve ta kthejnë mbrapsht

6 milionë euro të Startup Albania: Përfituesit, qokat dhe "problematicët"

Na ndiq

Facebook

Instagram

krerëve të UÇK-së. Çdo apelim shqyrtohet mbi provat dhe argumentet konkrete të çështjes përkatëse.

Por historia e drejtësisë ndërkombëtare tregon se rruga gjyqësore nuk përfundon domosdoshmërisht me vendimin e shkallës së parë. Rasti i gjeneralit kroat mbetet një shembull i qartë se si një vendim i rëndë mund të ndryshojë në mënyrë rrënjësore në Apel.

Gotovina UÇK

SHARE.



YouTube

TikTok

RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A
Email: radarlajme@gmail.com
Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator

Një ditë me surpriza në dashuri:
Horoskopi për të gjitha shenjat

Pak dramë, shumë ndjenja:
Horoskopi i dashurisë për këtë javë



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

raporto këtu

© Radar.al. dizenuar nga 1001solutions

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.